REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Numri i Ceshtjes :** | 61002-00586-51-2019 | **Data e Regjistrimit :** | 15/02/2019 |
| **Numri i Vendimit:** | 51-2019-1415 | **Data e Vendimit :** | 20/03/2019 |

# VENDIM

## NË EMËR TË REPUBLIKËS

## GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR E PËRBËRË NGA:

**GJYQTAR:** Andri Ymeri

**SEKRETARE:** Marterina Pleshaj

Sot më datë 20/03/2019mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues Jonida Pepaj, i biri i Agostin dhe i ., i datëlindjes 18/08/1994

**Objekti:**Kerkese per heqjen e sekuestros preventive me vendimin nr.575, date 11.05.2018 te Gj.Rrethit Shkoder

**Baza Ligjore:**Neni 274/3 I K.Pr.Penale

**VEREN :**



REPUBLIKA E SHQIPERISE - PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE SHKODER - SEKRETARIA

**Nr. Rregj. Them.95 (586) Nr. Vendimi 95 (1415)**

**Dt. Rregj. 15/02/2019** **Dt. Vendimi 20/03/2019**

V E N D I M

**"Per heqje e sekuestros preventive"**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder, e perbere nga:

Andri Ymeri – Gjyqtar

Asistuar nga sekretare seance Marterina Pleshaj, sot me date 20/03/2019, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative penale qe i perket:

**KERKUES:** [redacted] e bija e [redacted] e dtl. [redacted], lindur ne Koplik, Malesi e Madhe dhe banuese ne Hot, perfaqesuar me prokure nga av.Ilir Golemi.

[redacted], i biri i Kole, i dtl. [redacted] lindur ne Tuz, Mal i Zi, perfaqesuar me prokure nga av.Ilir Golemi.

**PERSON I INTERESUAR: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Shkoder**, perfaqesuar nga prokurori Ermir Lelçi.

**OBJEKTI**: Heqje sekuestro preventive.

**BAZA LIGJORE**: Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

Ne perfundim te gjykimit, perfaqesuesi i kerkuesave, [redacted] dhe [redacted], Av.Ilir Golemi kerkoi heqjen e sekuestros se vendosur me vendimin nr.487 (2347), dt.11/05/2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, ndersa organi i Prokurorise kerkoi rrezimin e kerkeses.

Gjykata pasi shqyrtoi ne teresi çeshtjen

**VEREJ se**

Gjate gjykimit rezultoi e provuar se me vendimin nr.487 (2347), date 11.05.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, eshte disponuar vendosja e sekuestros preventive, mbi disa pasuri te paluajtshme, njesi sherbimi dhe toka bujqesore te treguara ne pjesen urdheruese te ketij vendimi. Ky vendim gjyqesor rezulton se ka marre forme te prere dhe eshte vene ne ekzekutim nga Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder.

Permbledhtaz, shkaku perse Gjykata ka urdheruar vendosjen e sekuestros preventive mbi keto pasuri, konsiston ne faktin se shtetasit [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted], qe jane personat ne emer te te cileve figurojne te rregjistruara titujt pronesore mbi pasurite e sekuestruara, jane te dyshuar nga Prokuroria si autore te vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, ka filluar procedimin penal nr. 109 te vitit 2018, per hetimin e kesaj vepre penale, per arsye se nga autoritetet zyrtare te Republikes se Malit te Zi, jane vene ne dijeni te faktit se me daten 17.12.2017, rreth ores 16:00, ne territorin e Malit te Zi, eshte arrestuar shtetasi shqiptar [redacted], duke u sekuestruar gjate arrestimit, nje sasi prej 982 kg marihuane, 1,7 kg heroine dhe 13 kg perzieres.Se bashku me kete shtetas jane arrestuar, ne kuader te operacionit policor te zhvilluar nga autoritetet policore te Malit te Zi, edhe 12 shtetas te tjere. Sipas autoriteteve malazeze, shtetasi [redacted] dyshohet se eshte kreu i nje organizate kriminale qe merret me shitjen dhe tregtimin e lendeve narkotike.

Sipas Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder, ekziston dyshimi se shtetasi [redacted] te ardhurat e fituara nga veprimtaria kriminale per te cilen eshte arrestuar nga organet policore te shtetit te huaj, i ka investuar ne territorin e Republikes se Shqiperise, duke u perfshire ne transaksione qe kane patur per qellim fitimin e pronesise apo krijimin permes ndertimit, te pasurive te paluajtshme te sekuestrura me vendimin nr.487 (2347), date 11.05.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder.

Po sipas Prokurorise, titujt e pronesise mbi keto pasuri, ne pjesen me te madhe te tyre jane vene ne

emer te shtetasve qe kane lidhje te aferta familjare me shtetasin [redacted], qe jane shtetasit [redacted], (kunati), [redacted] (bashkeshortja) dhe [redacted], (i lindur ne Tuz, Mal i Zi dhe banues ne Britanine e Madhe).

Sipas Prokurorise, meqenese keto persona, permes perdorimit te emrit te tyre, ne rregjistrimin dhe fitimin e titujve pronesore mbi keto pasuri, ne thelb e kane ndihmuar shtetasin [redacted], per te fshehur emrin e tij *si pronar i vertete i pasurive qe dyshohet se jane fituar nga veprimtaria kriminale*, si ata ashtu edhe vete shtetasi [redacted], dyshohet se kane konsumuar vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Per teresine e faktit te lartepermendur, te pasqyruar nga Gjykata ne menyre te permbledhur, (*me hollesisht shih vendimin nr. 487 (2347), date 11.05.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder*), Gjykata ka pranuar kerkesen e Prokurorise, per vendosjen e sekuestros preventive mbi keto pasuri.

Me daten 15.02.2019, shtetasit [redacted] dhe [redacted], kane paraqitur ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Shkoder, kerkesen ne gjykim, me objekt "*heqjen e sekuestros preventive te vendosur me vendimin nr. 487 (2347), date 11.05.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder*".

Keta dy kerkues gjate gjykimit, u mbrojtjen dhe u perfaqesuan nga av. Ilir Golemi, anetar i Dhomes se Avokatise Shkoder.

Kerkesen me objekt si me siper, av. Ilir Golemi, ne emer dhe per llogari te dy kerkuesve [redacted] dhe [redacted] e motivoi duke arsyetuar permbledhtaz, shkaqet e meposhtme:

a. Pasurite e sekuestruara qe figurojne te rregjistruara ne rregjistrat publike te pasurive te paluajtshme, ne emer te [redacted], nuk jane fituar me te ardhura te realizuara nga ndonje veprimtari kriminale, por me punen e ndershme te vete [redacted], bashkeshortes se tij dhe femijeve te tij. Sipas av. Ilir Golemi, [redacted] ka rreth 20 vjet qe banon ne Britanine e Madhe. Ai dhe familjaret e tij, kane realizuar fitime mbi 200.000 (dyqind mije) paund ne vit, me pune te ndershme, gje qe vertetohet lehtesisht nga disa mandate bankare (qe vertetojne te ardhurat vjetore te realizuara prej tij dhe familjareve te tij ne Britaine e Madhe). Sipas av. Ilir Golemi, te ardhurat e realizuara dhe te deklaruara sipas ligjit, prane autoriteteve britanike, e kapercejne shume here vleren e pasurive te sekuestruara, dhe eshte absurde te pretendohet se pasurite e sekuestruara, jane krijuar me burime financiare te pajustifikuara dhe aq me pak nga burime kriminale.

b. Persa i perket pasurive te sekuestruara te [redacted] dhe [redacted], qe jane toka are apo troje, ato nuk jane krijuar me te ardhura nga ndonje veprimtari kriminale, por jane fituar me akte administrative, sipas ligjit nr. 7501 "Per token".

c. Nga ana e Prokurorise, ndonese ka mbi 10 muaj qe zhvillohen hetime, nuk eshte siguruar asnje prove apo e dhene qe pasurite e sekuestruara, jane krijuar me burime te pajustifikuara, dhe aq me pak me te ardhura nga ndonje veprimtari kriminale, (veçanarisht, veprimtari qe ka per autor shtetasin [redacted]). Nga ana e Prokurorise jane shkelur ne menyre flagrante normat ligjore te parashikuara ne Kodin e Procedures Penale, per zgjatjen e hetimeve paraprake, njoftimin e vendimeve qe ka marre prokurori per zgjatjen e hetimeve, te pandehurit apo personit nen hetim, etj.

Lidhur me kerkesen ne gjykim, perfaqesuesi i Prokurorise, Prokurori Ermir Lelçi, kerkoi rrezimin e saj. Kjo duke arsyetuar permbledhtaz, si me poshte:

a. Nuk ka ndryshuar ndonje rrethane fakti apo ligji, mbi bazen e te ciles te jete e nevojshme heqja e sekuestros preventive.

b. Nga hetimet e deritanishme, jo vetem qe nuk ka ndonje te dhene apo prove, qe te tregoje faktin se pasurite e sekuestruara jane vene me burime te ligjshme dhe te justifikuara, por ka dyshime shtese, (ne raport me kohen fillestare kur eshte vendosur nga Gjykata sekuestroja preventive), se nje pjese e

pasurive nen sekuestro, dhe posaçerisht tokat dhe/apo trojet, jane produkte te vepres penale te "Shperdorimit te detyres" te parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo pasi, titujt pronesore mbi keto pasuri te fundit, jane krijuar si rezultat i shperdorimit te detyres nga personat zyrtare qe kane patur kompetencen ligjore per t'i transferuar ato, ne pronesi te subjekteve private.

*Gjykata evidenton faktin se prokurori nuk paraqiti asnje prove te vetme per te vertetuar pretendimet e tij dhe po ashtu nuk paraqiti si prove, asnje akt procedural, nga i cili te krijohet tek Gjykata bindja se Prokuroria ka treguar diligjencen e duhur (zellin e mjaftueshem) per te zhvilluar hetime, mbledhur te dhena apo kerkuar prova si dhe produktet e kesaj veprimtarie hetimore, pas kohes qe eshte vendosur nga Gjykata, sekuestroja preventive mbi pasurite.*

*Per me teper, Prokurori **(i pyetur nga Gjykata)** shpjegoi gjate gjykimit, se nuk rezulton qe ne rregjistrimin e autoreve te veprave penale te Prokurorise, te jene shenuar emrat e shtetasve N[redacted] P[redacted]j, G[redacted]j T[redacted]j, M[redacted]L[redacted] dhe J[redacted] P[redacted] si persona nen hetim per kryerjen e vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Per rrjedhoje nuk ka qene e nevojshme qe prokurori te merrte vendime zgjatjeje apo t'ia njoftonte keto vendime personave nen hetim.*

Gjykata pasi e shqyrtoi çeshtjen ne teresi, arsyeton si me poshte vijon:

**Se pari**: Sipas vleresimit te Gjykates, vendosja e masave te sigurimit personal dhe/apo pasuror (ku perfshihet edhe vendosja e sekuestros preventive), ne thelbin e tyre perfaqesojne "*kufizim te lirise dhe/apo te drejtave*", ndaj personave qe preken nga zbatimi i ketyre masave.

Ne zbatim te parimit te ligshjmerise dhe proporcionalitetit, kufizimet e lirise si permes masave te sigurimit personal ashtu edhe permes masave te sigurimit pasuror (*sekuestro preventive apo sekuestro konservative*), jane te lejueshme te behen vetem ndaj subjekteve se kane statusin e te pandehurit apo te pakten te "personit nen hetim" (*qe sipas nenit 34/a te Kodit te Procedures Penale, ka te njejtat te drejta dhe garanci, me te pandehurin*[1]).

Ne rastin ne gjykim, konstatohet se perderisa Prokurori nuk ka marre vendim, (pas vendosjes se sekuestros preventive), per zgjatjen e afatit te hetimit paraprak, sipas nenit 324 te Kodit te Procedures Penale[2] (*ose nuk ia ka njoftuar kegto vendime te mundshme zgjatjeje personave nen hetim*), atehere mbeten te hapura dy alternativa te mundshme, (*secila prej te cilave shkon kunder argumentit te nevojshmerise se vazhdimit te sekuestros preventive*), dhe qe jane:

1. Ose "***Prokurori nuk e ka rregjistruar emrin e te shtetasve qe preken nga sekuestroja preventive, si persona nen hetim, ne rregjistrin e autoreve te veprave penale te Prokurorise***", gje qe do te vinte ne kundershtim me nenin 287 te Kodit te Procedures Penale, [3], duke sjelle si pasoje, pamundesine ligjore te vendosjes se sekuestros preventive (*apo te çfaredolloj mase tjeter sigurimi, me natyre personale apo pasurore*), ndaj personave te cileve nuk iu eshte rregjistruar emri, ne rregjistrin e autoreve te veprave Penale te Prokurorise.

2. Ose "***Prokurori ka zhvilluar hetime dhe marre prova pa bere zgjatje hetimesh apo njoftuar vendimet e zgjatjeve personave nen hetim***", gje qe do te vinte ne kundershtim me nenin 324/4 te Kodit te Procedures Penale, duke shkaktuar paperdorshmerine e provave.

Gjykata nuk konstatoi gjate ketij gjykimi, ndonje te dhene qe te beje te besueshme hipotezen e dyte (*pra qe Prokuroria me mosveprim per te bere zgjatje hetimesh, ka shkaktuar paperdorshmerine e provave te marra nga hetimet e zhvilluara pas vendosjes se sekuestros preventive*), dhe per rrjedhoje konsideron te besueshme hipotezen e pare (*sipas te ciles Prokuroria ka kerkuar vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite, pa rregjistruar me pare, emrin e personave qe preken nga kjo sekuestro, ne rregjistrin e autoreve te dyshuar te veprave penale te Prokurorise, dhe ne vijim, akoma deri tani, prokuroria nuk e ka bere kete rregjistrim te statusit te personave qe preken nga sekuestroja preventive, ne kete rregjister*).

Sipas vleresimit te Gjykates, te krijuar nga intepretimi pajtues i nenit 287 te Kodit te Procedures Penale, me nenet 274 dhe 275 te Kodit te Procedures Penale (qe rregullojne sekuestron preventive[4]), asnje mase sigurimi personal apo mase sigurimi pasuror (***ku perfshihet edhe sekuestroja preventive***), nuk mund te caktohet (*dhe nese eshte caktuar, nuk mund te vazhdoje*), nese personi i prekur nga "*keto kufizime te lirive apo te drejtave individuale*", nuk ka "te pakten" statusin e personit nen hetim, per ndonje veper penale. Nese e kunderta do te ndodhte, kjo gje do te vinte ne kundershtim te hapur me parimin e ligjshmerise, pasi ketyre personave te prekur nga "keto kufizime te lirise", duke nuk t'i garantohej asnje lloj mbrojtjeje nga arbitraritetet apo paligjshmerite e mundshme apo te supozuara prej tyre ne procesin penal dhe nuk do t'i garantohej "akses i mjaftueshem", ne ushtrimin e te drejtes per nje process te rregullt ligjor.

Ne krijimin e bindjes si me siper, Gjykata arsyeton logjikisht se "*perderisa prokuroria ka vleresuar se provat qe ka mbledhur nuk i kane mjaftuar per te krijuar dyshimin e arsyeshem qe eshte i nevojshem per te rregjistruar emrin e shtetasit [redacted] etj, ne rregjistrin e autoreve te veprave penale te Prokurorise*", atehere eshte absurde qe Prokuroria te kerkoje vazhdimin e sekuestros preventive, "*e cila meqenese perben ne vetvete "kufizim lirie", duhet qe per t'u vendosur dhe/apo vazhduar, te garantoje dhe siguroje nje standart me te larte te dyshimit te arsyeshem te bazuar ne prova, se thjesht rregjistrimi i emrit te autorit ne rregjistrit e veprave penale te prokurorise*".

**Se dyti**: Nga pikpamja substanciale, Gjykata konstaton se Prokuroria nuk ka treguar zellin e mjaftueshem ne ndjekjen e procedimit. Kjo pasi ndonese kane kaluar mbi 10 muaj nga zbatimi i sekuestros preventive, Prokuroria akoma nuk ka disponuar kryerjen e nje ekspertimi vleresues, me qellim per te percaktuar vleren pasurore te sendeve te sekuestruara, dhe aq me pak, te kete administruar si prove, ndonje akt eksperitimi te kesaj natyre. Gjykata evidenton faktin se pa u percaktuar vlera e sendeve te sekuestruara, as Prokuroria nuk ka mundesi objektive te argumentoje dyshimin se keto pasuri jane fituar dhe/apo krijuar nga burime te veprimtarise kriminale, dhe as personat qe preken nga masa e sekuestros preventive, nuk kane mundesi objektive per te vertetuar te kunderten, pra se keto pasuri jane fituar nga burime te ligjshme. Pikerisht kohen e gjate qe ka kaluar, nga zbatimi i mases se sekuestros preventive, Gjykata e vlereson ne drejtim te pranimit te kerkeses per heqjen e sekuestros preventive. Kjo pasi ne çdo rast, sipas vleresimit te Gjykates, eshte detyre e Prokurorise, qe te mos mjaftohet me nivelin fillestar te provave, mbi te cilat Gjykata ka urdheruar kufizimin e lirise dhe/apo te drejtes permes zbatimit te mases se sekuestros preventive, por kete nivel fillestar provueshmerie, t'a pasuroje akoma me tej, gjate vijimit te hetimeve te metejshme. Sipas bindjes se Gjykates, vete fakti i lejimit te kalimit te kohes ne menyre pasive nga ana e Prokurorise, perben nje rrethane fakti qe padyshim e zbeh nivelin fillestar te provave qe i kane sherbyer Gjykates per te vendosur sekuestron preventive, dhe ne analize te fundit, eshte faktor shtese, qe sherben si argument ligjor per heqjen e kesaj mase te sigurimit pasuror.

**Se treti**: Gjate gjykimit, av. Ilir Golemi, paraqiti si prove disa mandate bankare te marra nga Britania e madhe, nga te cilat ne pamje te pare, te kryjohet dyshimi i arsyeshem se shtetasi [redacted] dhe anetaret e familjes se tij, kane te ardhura vjetore shume te larta. Sipas vleresimit te Gjykates, eshte detyre e Prokurorise qe te beje analizen krahasimore te ketyre te ardhurave te pretenduara, me vleren e pasurise se sekuestruar dhe ne vijim te arrihet ne konkluzionin nese pasurite qe figurojne ne emer te shtetasit Gjergj Tatiqaj, jane apo jo te justifikuara me burime te ligjshme. Pikerisht, deshtimin e Prokurorise per te permbushur kete "barre prove" qe asaj i ngarkon ligji, Gjykata e konsideron si argument ne favor te pranimit te kerkeses se paraqitur nga kerkuesi [redacted], per heqjen e sekuestros preventive mbi pasurite qe i jane sekuestruar atij.

**Se katerti**: Lidhur me kerkuesin [redacted], Gjykata evidenton faktin se Prokurria as nuk pretendoi

dhe aq me pak paraqiti ndonje prove se ku lidhet ky shtetas me shtetasin [redacted], pra cilat jane lidhjet e supozuara, familjare, shoqerore, etj, te cilat bejne te besueshme hipotezen se shtetasi [redacted], ka pranuar qe te perdore shenimin e emrit te tij, ne aktet zyrtare te fitimit te disa prej pasurive te sekuestruara, dhe rregjistrimin ne rregjistrat publike te ketyre pasurive, me qellim per te fshehur faktin se shtetasi [redacted] eshte pronari i vertete i ketyre pasurive. Kjo gje sipas vleresimit te Gjykates, perben nje argument tjeter shtese, (krahas argumenteve te mesiperme), ne favor te pranimit te kerkeses se paraqitur nga kerkuesi [redacted] per heqjen e sekuestros preventive mbi pasurise qe i jane sekuestruar atij.

**Se pesti**: Gjykata e vlereson me vend te evidentoje faktin se nese Prokuroria ka dyshime te arsyeshme se pasurite per te cilat eshte vendosur sekuestroja preventive, jane krijuar nga burime me natyre kriminale, por nuk ka prova per t'a vertetuar kete dyshim, atehere ajo nuk mund te perdore "sekuestron preventive" te parashikuar nga Kodi i Procedures Penale, si mjet procedural per te realizuar bllokimin e perkohshem te ketyre pasurive. Kjo pasi sipas Kodit te Procedures Penale, per t'u vendosur ligjerisht çfaredo lloj "*kufizim lirie dhe/apo te drejte*", si me natyre personale ashtu edhe me natyre pasurore, ne çdo rast, "*barra e proves per te perligjur dyshimin e arsyeshem te nevojshmerise te kufizimit te lirise dhe/apo te drejtes*", ***i perket ne çdo rast Prokurorit***. Gjykata duke u treguar e balancuar ne drejtim si te respektimit te ligjshmerise ashtu edhe te barazise, vlereson se duhet te tregohet e permbajtur duke u mjaftuar thjesht me evidentimin e faktit se legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, parashikon ne menyre te posaçme, instrumente ligjore per zhvendosjen apo permbysjen e kesaj "barre prove", ne rastet kur fokusi i aplikimit te masave kufizuese, eshte pasuria e individit, si dhe menyra dhe rregulla qe duhet te ndiqen per realizimin e ketij qellimi, por nuk eshte detyre e Gjykates por e Prokurorise se Shtetit, per t'i evidentuar hollesisht, per t'i gjetur dhe per t'i zbatuar ato.

**Se gjashti**: Ne lidhje me pronat qe figurojne ne emer te shtetasit [redacted], Gjykata vlereson se perderisa ky shtetas nuk perfshihet ne rrethin e autoreve qe kane paraqitur kerkesen ne kete gjykim, Gjykata nuk duhet te shprehet, duke qendruar kesisoj sekuestroja preventive ne fuqi, por vetem persa i perket pronave qe figurojne ne emer te ketij shtetasi.

**Se shtati**: Edhe ne lidhje me pronat qe figurojne ne emer te shtetasit [redacted], Gjykata vlereson se perderisa ky shtetas nuk perfshihet ne rrethin e autoreve qe kane paraqitur kerkesen ne kete gjykim, Gjykata nuk duhet te shprehet, duke qendruar kesisoj sekuestroja preventive ne fuqi, por vetem persa i perket pronave qe figurojne ne emer te ketij shtetasi. Ketu Gjykata çmon te evidentoje faktin se vertete qe gjate ketij gjykimi u vertetua se kerkuesja [redacted], ehste bashkeshortja e kerkuesit [redacted], por ajo ne asnje rast nuk legjitimohet t'a paraqese kerkesen ne gjykim, ne emer dhe per llogari te bashkeshortit te saj. Kjo pasi gjate ketij gjykimi, nuk rezultoi e provuar se keta dy shtetas nuk kane te lidhur ndermjet tyre ndonje kontrate martesore (sipas rregullimeve te Kodit te Familjes), me qellim per te percaktuar ndonje rregjim te ndare te pasurive bashkeshortore.

**Se teti**: Ne lidhje me pretendimin e Prokurorit se "*nga hetimet e deritanishme, jo vetem qe nuk ka ndonje te dhene apo prove, qe te tregoje faktin se pasurite e sekuestruara jane vene me burime te ligjshme dhe te justifikuara, por ka dyshime shtese, (ne raport me kohen fillestare kur eshte vendosur nga Gjykata sekuestroja preventive), se nje pjese e pasurive nen sekuestro, dhe posaçerisht tokat dhe/apo trojet, jane produkte te vepres penale te "Shperdorimit te detyres" te parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo pasi, titujt pronesore mbi keto pasuri te fundit, jane krijuar si rezultat i shperdorimit te detyres nga personat zyrtare qe kane patur kompetencen ligjore per t'i transferuar ato, ne pronesi te subjekteve private*", Gjykata evidenton faktin se ky pretendim nuk u mbeshtet ne prova. Kjo pasi prokurori nuk paraqiti ndonje prove per te vertetuar "*as vazhdimin e ekzistences dhe jo me thellimin e dyshimit te arsyeshem se personat e prekur nga zbatimi i sekuestros preventive*, jane autore te



REPUBLIKA E SHQIPERISE PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE SHKODER SEKRETARIA

mundshem te pastrimit te produkteve te vepres penale qe rrjedh nga vepra penale baze e "Shperdorimit te detyres", e parashikuar nga neni 248 i Kodit te Procedures Penale.

**Ne perfundim**: Duke u mbeshtetur ne teresine e arsyeve te larteperemendura, Gjykata krijon bindjen se sekuestroja preventive e vendosur me vendimin nr.487 (2347), date 11.05.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, duhet hequr, me perjashtim te pasurive qe figurojne ne pronesi te Ndue Vasel Pepaj dhe Mikel Livadhi.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenet 274 dhe 275 te K.Pr.Penale

**V E N D O S I**

- Pranimin e pjes'shem te kerkeses.
- Heqjen e sekuestros preventive te vendosur me vendimin nr.487 (2347), dt.11/05/2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, me perjashtim te sekuestros se vendosur per:

•€€€€€€€€ Pasurine nr.120/3, zona kadastrale 1989, pemtore, me siperfaqe 4707 $m^2$, e ndodhur ne fshatin Ivanaj, Bashkia Malesi e Madhe, e shitur nga N[redacted]e P[redacted]j dhe e blere nga M[redacted] L[redacted], me kontrate nr.4130rep, nr.2866kol, dt.28/07/2015, perpara notere Valbona Hajdari.

•€€€€€€€€ Pasurine nr.729/4, zona kadastrale 1964, pemtore, me siperfaqe 4510 $m^2$, e ndodhur ne Hot, Bashkia Malesi e Madhe, e regjistruar ne emer te shtetasit N[redacted] Vasel R[redacted]j.

- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit Shkoder, brenda 10 diteve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes se vendimit.

U shpall sot me daten 20/03/2019.

**Sekretare** **Gjyqtar**

**Marterina Pleshaj** **Andri Ymeri**

---

[1] **Neni 34/a, paragrafi i trete, percakton** " *Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe*".

[2] **Neni 324 i Kodit te Procedures Penale percakton** "*1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj.*

*2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Tej afatit 2-vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit. Tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.*

*3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës.*

*4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.*".

[3] **Neni 287 i Kodit te Procedures Penale, percakton**: *1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.*

[4] **Neni 274 i Kodit te Procedures Penale**: *1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të 153 lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.*

*3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.*

**Neni 275 i Kodit te Procedures Penale**: *Humbja e fuqisë së sekuestros 1. Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale.*

*2. Kur është dhënë vendimi i dënimit, efektet e sekuestros vazhdojnë në rast se është vendosur konfiskimi i sendeve të sekuestruara.*

*3. Sendet e sekuestruara nuk kthehen kur gjykata vendos që të mbahet sekuestroja për garantimin e kredive.*

**Për këto arsye**

**VENDOSI:**

**SHPENZIMET GJYQESORE**

| | |
|---|---|
| **Kërkesëpadia** | 0 |
| **Taksa Gjyqësore** | 0 |
| **Noterizime** | 0 |
| **Njoftime** | 0 |
| **Akt ekspertimi** | 0 |
| **Avokat** | 0 |
| **Gjithsej** | 0 |

**GJYQTAR:**

**Andri Ymeri**